

# RAPORT STUDIMOR

## INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA KUKËS



QENDRA PËR PROGRES RINOR  
QERSHOR 2022

## Tabela e përmbajtjes

|  |    |
|--|----|
| 1. Hyrje .....   | 3  |
| 2. Koncepte dhe përkufizime .....  | 4  |
| 3. Profili i Bashkisë Kukës .....  | 5  |
| 4. Metodologjia .....  | 7  |
| 5. Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik ..... | 8  |
| 6. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë Kukës .....            | 12 |
| 7. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak.....         | 21 |
| 8. Konkluzione .....   | 28 |
| 9. Rekomandime .....   | 29 |

## 1. Hyrje

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatrat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse ne Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetarët pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe

informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra për Progres Rinor Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.

## 2. Koncepte dhe përkufizime

|       |   |
|-------|---|
| BP    | Buxhetimi me Pjesëmarrje                |
| BPGJ  | Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor         |
| KB    | Këshilli Bashkiak                       |
| KKQV  | Komisione Këshillimore Qytetare Vendore |
| GADC  | Gender Alliance Development Center      |
| GMS   | Grupi i Menaxhimit Strategjik           |
| NED   | National Endowment for Democracy        |
| NJVQV | Njësi e Vetëqeverisjes Vendore          |
| OPIC  | Olof Plame International Centre         |
| OSHC  | Organizatë e Shoqërisë Civile           |
| PBA   | Programi Buxhetor Afatmesëm             |
| QV    | Qeverisje Vendore                       |
| RAT   | Reforma Administrativo-Territoriale     |

### 3. Profili i Bashkisë Kukës

Bashkia Kukës kufizohet në veri me Bashkinë Has, në perëndim me bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit. Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia është 47,985 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 933.86 km<sup>2</sup> me një densitet prej 63.59 banorë/km<sup>2</sup>. Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administratedhe 87 fshatra. Deri në vitet '90, Kukësi kishte industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimit të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj). Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit.

#### Qeverisja vendore

Gjendja aktuale e qeverisjes vendore është produkt i dinamikës së një sërë reformash institucionale për decentralizimin dhe autonominë vendore. Procesi i decentralizimit dhe i autonomisë vendore u materializua edhe më tej me miratimin e Kushtetutës dhe nënshkrimin e Kartës Europiane për Autonominë Lokale. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, ndërsa Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore. Me miratimin e ligjit 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", ndarja e re territoriale përcakton si njësi të qeverisjes vendore 61 bashki dhe 12 qarqe. Bashkia e Kukësit është pjesë e qarkut Kukës dhe përbëhet nga 15 njësi të qeverisjes vendore (Kukës, Malzi, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqën, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Gryk-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën, Kolsh) dhe 87 fshatra. Në çdo bashki krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Këshilli Bashkiak Kukës përbëhet nga 31 këshilltarë, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike të zgjedhur në zgjedhjet vendore.

## Demografia

Aktualisht Qarku Kukës ka trend negativ i cili vazhdon prej vitesh<sup>1</sup>. Ky trend është evident edhe në bashkinë Kukës.

Popullsia më 1 janar sipas qarkut dhe gjinisë; Janar 2022.

| Qarku | 2020  |       | Gjithsej | 2021  |       | Gjithsej | 2022  |       | Gjithsej |
|-------|-------|-------|----------|-------|-------|----------|-------|-------|----------|
|       | M     | F     |          | M     | F     |          | M     | F     |          |
| Kukës | 38748 | 36680 | 75428    | 38213 | 36175 | 74388    | 37361 | 35407 | 72768    |

## Profili ekonomik

Ekonomia e Qarkut të Kukësit është e zhvilluar në disa degë si: bujqësia, blegtoria, peshkimi, turizmi, hidrocentralet, transporti etj. Qarku i Kukësit është i përbërë nga tre rrethe të cilët janë: Rrethi i Kukësit, Rrethi Hasit, dhe Rrethi i Tropojës. Ekonomia e rajonit ka lëvizur nga bujqësia drejt ndërtimit, industrisë dhe shërbimeve. Sektorët ekonomike prioritarë dhe me potencial të rëndësishëm zhvillimi, rritje ekonomike dhe punësimi janë: turizmi, sektori minerar dhe bimët medicinale. Rajoni ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet natyrore të maleve, kullotat alpine, luginat e thella si dhe liqenet dhe lumenjtë.

Për sa i përket performancës ekonomike, Kukësi është konsideruar gjithmonë si një ndër rajonet më të varfëra të vendit. Sipas përlogaritjeve të Bankës Botërore të ardhurat për frymë janë 1753 Euro në vit ndërkohë që të ardhurat për frymë mesatare në shkallë vendi janë 2469 Euro. Megjithatë këto vlera mund të jenë të nënvlerësuara nëse marrim parasysh efektin e shpopullimit. Gjatë tetë viteve të fundit ekonomia ka lëvizur nga bujqësia drejt ndërtimit, industrisë dhe shërbimeve. Që nga 2002, pjesa që zë vlera e shtuar bruto e bujqësisë dhe tregtisë me shumicë e pakicë kanë rënë përkatësisht me -14% dhe -15% ndërkohë që industria, ndërtimi dhe shërbime të tjera janë rritur respektivisht me 63%, 44% dhe 15%<sup>2</sup>.

<sup>1</sup><http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2>

<sup>2</sup><http://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-rajonale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/publikimet/2022/prodhimi-i-brendsh%C3%ABm-bruto-sipas-rajoneve-statistikore-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2020/>

## Mjetet e informimit

Me hyrjen në fuqi të Reformës së re Administrativo - Territoriale, ligji nr.115/2014 “Përndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”,

ofrimi i shërbimeve për qytetarët në njësitë administrative, kërkon implementimin e një sistemi informatik, i cili zbaton procedurat e miratuara paraprakisht nga Bashkia (rregulloren e shërbimeve administrative dhe manualin përkatës). Bashkia Kukës me njësitë e saj administrative ofrojnë shërbime sipas modelit të zyrave me një ndalesë duke garantuar kosto të ulët shërbimi dhe kohë më të shkurtuar, duke rritur transparencën dhe cilësinë e shërbimeve të saj.

## 4. Metodologjia

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Kukës janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e

mjetet që do të përdoreshin për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

## **5. Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik**

Njoftimi, informimi dhe komunikimi i vazhdueshëm është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut e sidomos për transparencën dhe vendimmarrjen. Institucione të ndryshme përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun qoftë në funksion të promovimit të aktiviteteve të tyre apo në funksion të përmbushjes për të drejtën për informim, njoftim e konsultim.

Ndër elementët kryesorë për të mbajtur një publik të informuar janë edhe mediat e ndryshme të cilat ndiqen nga qytetarët. Përdorimi i teknologjive të reja dhe mediave sociale ka shtuar ndjeshëm nivelin e komunikimit midis institucioneve dhe publikut, aktorëve politikë e publikë me publikun dhe anasjelltas.

Kërkesat dhe ankesat me shkrim paraqiten në sektorin e Marrëdhënieve me Publikun. Afati për dhënien e përgjigjes kërkesave apo ankesave të qytetarëve është 45 ditë nga dita e paraqitjes së saj sipas ligjit, por në praktikën e përditshme është i përsheptuar.



Pritja e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve bëhet nga nëpunësit e Sektorit, të cilët pasi dëgjojnë qytetarët, plotësojnë bashkarisht formularin përkatës dhe e përcjellin këtë kërkesë/ankesë drejtorisë përkatëse, në varësi të specifikave të kërkesës apo ankesës. Vizitorët do të lejohen të hyjnë nëpër zyra, vetëm pasi nëpunësi i zyrës së pritjes të ketë komunikuar dhe të ketë marrë miratim nga nëpunësi që pret vizitën. Në çdo rast, vizitori pajiset me një fletë-hyrje, ku shënohen zyra që e pret dhe kohëzgjatja e vizitës.

**Zyra me një ndalesë** është kontakti i parë me qytetarët sapo futesh në bashki. Në Njësitë Administrative si ofruet të inframcionit mbeten punonjësit por në një formë të pastrukturuar. Gjithashtu duke filluar nga 1 Maj 2022 me kalimin e shërbimve online shumë qytetar kanë hasur vështirësi për marrje të dokumentave të nevojshëm dhe ka patur rritje të kostove.

Në zyrën me një ndalesë punonjësit merren me problematikat dhe çështjet e qytetarëve duke i drejtuar ato në strukturat përkatëse për zgjidhje. Shërbimet e zyrës me një ndalesë lehtësojnë marrëdhënien e qytetarëve dhe bizneseve, për një sërë grup shërbimesh administrative si: vërtetime, kërkesa, ankesa, aplikime për leje dhe autorizime të ndryshme, marrje informacioni etj. Zyra me një ndalesë quhet ndryshe edhe zyra e informacionit, ku bëhen kërkesa apo shkresa për informim.


### **Faqja Web e Bashkisë Kukës<sup>3</sup>**

Bashkia Kukës, si shumë institucione të tjera zotëron një faqe në web me prapashtesën gov.al. Kjo faqe në web është e ndërtuar më shumë mbi bazën e dhënies së informacionit në formën e shkruar dhe shikohet si një nga mënyrat e cila bashkia komunikon me qytetarët. Pamja e parë që shfaqet sapo hapim faqen janë disa foto të qytetit dhe një menu ku mund të klikojmë për të marrë informacione të ndryshme për: bashkinë, këshillin bashkiak, programin e transparencës, shpallje apo njoftime, informacione rreth Kukësit, për biznesin, për qytetarët, etj. Informacioni është përgjithsisht i pa plotë dhe ka më shumë publikimi të cilat i japin informacion të

---


<sup>3</sup><https://kukesi.gov.al/>

njëanshëm. Në rubrikën e Zëri Juaj mund të gjenden edhe njoftimet për konsultimet me publikun të cilat janë 2 për vitin 2022 dhe 4 për vitin 2021. Ndërkohë që një pyëtsor interaktiv i cili i dedikohet prioriteteve që qytetarët mund të propozojnë mund të gjendet nën të njëjtën kategori.



## Rrjeti Social Facebook

Faqja zyrtare në facebook e bashkisë menaxhohet nga punonjësit e zyrës së medias në këtë bashki. Bashkia Kukës në këtë faqe ka rreth 20 mijë ndjekës, të cilën e përdor si një platformë tjetër komunikimi dhe informimi për qytetarët. Nga monitorimi që është bërë postimet në këtë faqe janë pothuajse 2-3 në ditë në varësi të aktiviteteve. Postimet janë të përbëra nga foto dhe tekst të cilat tregojnë aktivitetet të ndryshme të bashkisë, përfundimin e projekteve të ndryshme, takime ose mbledhje si dhe promovimin e pikave të ndryshme turistike. Në faqen online të Bashkisë ka njoftime të cilat kanë të bëjnë me procesese konsultative dhe të detyrueshme sipas ligjit. Megjithate ato janë shume pak dhe pak mbërrijë tek qytetarët. Fokusimi tek projekte, ndërhyrje, aksione, promovime është dominues mbi pjesën tjetër.



## Komunikimet e drejtpërdrejta

Komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarin është një nga mënyrat më të përdorura në bashkinë Kukës dhe ndoshta edhe nga perceptimi metoda më e besueshme në transmetimin e mesazhit. Ky lloj komunikimi është edhe një nga mënyrat që bashkia Kukës ka zgjedhur të komunikojë me qytetarët e saj. Komunikimin ballë për ballë bashkia Kukës e realizon përmes dëgjësave publike<sup>4</sup> të cilat janë realizuar me iniciativë të Këshillit Bashkiak në bashkëpunim me bashkinë Kukës kryesisht dëgjesa për buxhetin afatmesëm, buxhetin vjetor dhe prioritetet komunitare të cilat zhvillohen në institucion në ditë të caktuara, për çdo problematikë apo çështje që kanë qytetarët.

Një praktikë e komunikimit direkt është edhe komunikimi dhe partneriteti i ndërtuar me Këshillin Bashkiak ku Kryetarja është ftuar në diskutime me të rinjtë ashtu siç edhe Kryetari i Bashkisë<sup>5</sup> ka pritur në takime individuale qytetarë të cilët kanë kërkuar mbështetje apo sqarime për çështje të ndryshme.

Programi transparencës është publikuar bazuar në ligj me 30/9/2019 pas fillimit të legjislaturës së re.

<sup>4</sup><https://kukesi.gov.al/category/njofime-mbi-degjesat-publike/>

<sup>5</sup>[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=580798930074579&id=100044334314367](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=580798930074579&id=100044334314367)

Në funksion të zbatimit të këtij programi, në partneritet me programin Bashki të Forta janë hartuar rregullore, janë miratuar forma dhe module të cilat i shërbejnë këtij procesi. Në rregulloren e KB Kukës janë të përfshira si ankesat, kërkesat, nismat qytetare dhe petitionet. Këto forma të transparencës dhe të iniciativës qytetare janë të rëndësishme për transparence dhe aksion qytetar.

Regjistri i kërkesave është i përditësuar deri në Dhjetor 2021<sup>6</sup>. Për periudhën 2022 nuk ka të dhëna.

Kontaktet janë lehtësisht të identifikueshme, nr tel, mail adresë e plotë.

Në pjesën e dedikuar për transparencë dhe llogaridhënie<sup>7</sup> mund të gjeni të dhëna për zbatimin e buxhetit, relacione, raporte dhe të dhëna financiare.

## 6. Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë Kukës

Të intervistuarit në Bashkinë Kukës janë punonjës të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me proçese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët. Anketimi me përfaqësues nga Bashkia Kukës<sup>8</sup> dhe nga Këshilli Bashkiak<sup>9</sup> synon të sjellë situatën aktuale në lidhje me pjesëmarrjen qytetare në proçese konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe mënyrat të cilat përdor institucioni në informimin e qytetarëve.

### ***Rëndësia e njoftimit në vendimmarrjen vendore***


Në zbatim të detyrimeve të parashikuar në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Në Bashkinë Kukës të anketuarit janë pyetur mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore, duke e cilësuar të gjithë si një proces *shumë të rëndësishëm*.

<sup>6</sup><https://kukesi.gov.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve/>

<sup>7</sup><https://kukesi.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ef/>


<sup>8</sup>R Hereni, E Tusha, E Velia, M Hasa, B Toshi

<sup>9</sup>A Vata, R Tusha, E Ramallari, A Biba, Y Zeneli



### ***Rëndësia e informimit në vendimarrjen vendore***


Rëndësia e informimit në vendimarrjen vendore për të gjithë punonjësit e bashkisë vlerësohet si një proces *shumë i rëndësishëm*. E drejta për informim është e garantuar në përputhje me ligjin 119/2014, ku secili mund të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, insitucionet publike duhet të garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit për të gjithë.



### ***Rëndësia e konsultimit në vendimarrjen vendore***


Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje, është një e drejtë e qytetarëve në kuadër të qeverisjes, po ashtu përbën edhe një detyrim qytetar për të kontribuar në drejtim të një qeverisjeje të mirë. Ligji 146/2014 "Për njoftimin dhe Konsultimin publik" si dhe ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", mbështesin dhe nxisin pjesëmarrjen efektive

gjithëpërfshirëse të komunitetit në qeverisjen vendore. Të anketuarit e vlerësojnë si një proces *shumë të rëndësishëm* konsultimin me publikun, po ashtu nga monitorimi Bashkia Kukës e ka realizuar këtë proces. Për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të përmbushen tre komponentët kryesorë të tij: njoftimi konsultimi dhe pjesëmarrja.




### ***Njohuria mbi bazën ligjore***

Njohuria mbi bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore, rreth 100% e të intervistuarve janë përgjigjur se e njohin ***mirë***.




Ndërsa, mbi vlerësimin e kuadrit ligjor 80% e të intervistuarve janë shprehur se është i qartë dhe i plotë, 20% janë shprehur se është i qartë por jo i plotë .



### **Ekzistenca e koordinorit për konsultimin publik dhe transparencën**


Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike. Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm, në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike dhe me detyra të përcaktuara qartë. Të intervistuarit në bashki janë përgjegjës në masën 80% për ekzistencën e koordinorit për konsultim publik dhe 20% janë përgjegjës që jo, ndërsa për transparencën 60% janë përgjegjës që po ka koordinorë dhe 40% janë përgjegjës që jo.



Të dhënat e koordinatorit duhet të afishohen publikisht, në faqen zyrtare të bashkisë. Nga monitorimet e kryera në faqen zyrtare web të Bashkisë Kukës të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik janë të publikuara dhe të njohura.

### **Mjetet që përdor Bashkia Kukës për njoftimin e qytetarëve**

Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Kukës duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Format e ndarjes së informacionit me qytetarët realizohen nëpërmjet; lajmërimeve publike të afishuara në ambientet e bashkisë (100%), lajmërim në mediat audiovizive (100%), lajmërim në mediat sociale Facebook etj (100%). Vihet re se lajmërimet individuale nëpërmjet postës (20%) dhe postës elektronike (40%) kryhen për çështje apo njoftime specifike për persona të caktuar dhe përdoren në raste të caktuara dhe web,dëgjesa publike,sondazhe etj (20%).




### **Regjistri Elektronik në Bashkinë Kukës**

Nga monitorimet në faqen web të bashkisë është i publikuar regjistri elektronik ku ndahen në regjistrin për ankesa, kërkesa dhe vërejtje, regjistri i projektakteve për konsultim publik të këshillit bashkiak, regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të këshillit si dhe regjistri i peticioneve dhe iniciativave qytetare. Nga anketimet e kryera




rreth 100% janë në dijeni të ekzistencës së regjistrimit elektronik dhe publikimit të tij online. Po ashtu nga vëzhgimet e kryera ky regjistër përditësohet nga zyra e teknologjisë pasi informacioni i shkon nga departamentet përkatëse.



### ***Mjetet e informimit për qytetarët***

Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Kukës për informimin e qytetarëve, vihet re rëndësia e këndeve të informimit në ambientet e bashkisë, faqja zyrtare e bashkisë si dhe mediat sociale pasi 100% e të intervistuarve i shohin si mjete të rëndësishme për informimin e qytetarëve. Më pas si format më të përdorura për informimin e qytetarëve janë zyrat me një ndalesë 20%. Regjistri elektronik (20%) si detyrim ligjor për publikimin e informacioneve që lidhen me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik si dhe bashkëpunimi me mediat lokale për ndarje informacionesh duke i parë ato si një nga platformat më të ndjekura nga qytetarët (40%). Ndërsa, materialet informuese fletëpalosje etj, (20%) është ndër format më pak të përdorura për informimin e qytetarëve dhe botimet e bashkisë të cilat nuk janë të përdorura.

Të anketuarit janë pyetur për sfidat dhe vështirësitë që ndeshin në njoftimin dhe informimin e publikut, ato kanë shprehur se komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë gjithmonë i thjeshtë, i strukturuar dhe i kuptueshëm.



### Aksesi i qytetarëve në dokumenta


Të anketurit janë pyetur mbi aksesin që kanë qytetarët për të marrë dokumenta apo informacione të ndryshme dhe në masën 100% ato janë përgjigjur se në Bashkinë Kukës informacioni për qytetarët është lehtësisht i aksesueshëm. Tek zyrat me një ndalesë është koordinatori për të drejtën për informim që i mundëson qytetarëve për t'u njohur me informacionin publik brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara me ligj. Institucioni po ashtu e ka për detyrë të prodhojë dhe të publikojë informacioni i cili është i thjeshtë dhe i kuptueshëm për qytetarin.



### Publikimi i akteve në faqen zyrtare

Në faqen zyrtare web të bashkisë në menunë Regjistri i akteve janë të publikuara të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Të intervistuarit pohojnë në masën 100% se realizohet publikimi i akteve në faqen zyrtare si dhe afishimi i tyre në vende të caktuara për çështje të ndryshme.




### ***Hartimi i programit të transparencës***

Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar programin e transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Program Transparence quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë. Programi i Transparencës publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.


Të intervistuarit u shprehën në masën 100% se bashkia harton dhe publikon programin e transparencës si dhe raportet vjetore për transparencën. {Nga monitorimi i kryer programi i transparencës si dhe hartimi dhe publikimi i raportve vjetore për transparencën në vendimmarrje janë të publikuara në faqen zyrtare dhe mund të aksesohen lehtësisht<sup>10</sup>

<sup>10</sup><https://kukesi.gov.al/programi-i-transparences-per-autoritetin-publik-bashkia-kukes/>.

Anketuesit pohojnë se programi i transparencës përfshin numrin e akteve të miratuar nga Bashkia përgjat vitit, numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes si dhe numrin e takimeve publike të organizuara.



### Trajnimet mbi detyrimet ligjore mbi informimin publik



Të intervistuarit janë pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut ku rreth 60% janë përgjigjur se kanë zhvilluar trajnime të tilla dhe 40% nuk kanë marrë trajnime.



Po ashtu, ato janë shprehur se ka gjithmonë nevojë për të tilla trajnime si për qytetarët ashtu dhe për nëpunësit. Njohja më e mirë e

ligjit nga ana e tyre do sillte përmirësime dhe kualitet në mënyrën e kuptimit dhe informimit adekuat .

## Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak.


Të intervisturit e Këshillit Bashkiak Kukës<sup>11</sup> e vlerësojnë në masën 100% rëndësinë e njoftimit dhe informimit në vendimmarrjen vendore. Njoftimi i publikut për mbledhjet e këshillit realizohet në forma të ndryshme duke e shikuar si një element shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e qytetarëve në procese të ndryshme konsultuese.

Përfaqësuesit e këshillit vlerësojnë 100% të rëndësishëm njoftimin, ndërsa informimin 66.7% e konsiderojnë shumë të rëndësishëm dhe 33.3% të rëndësishëm.



Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë një proces shumë i rëndësishëm sa i përket konsultimit publik në vendimmarrjen vendore. Pjesëmarrja qytetare është një e drejtë e qytetarëve në kuadër të qeverisjes, prandaj për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të ketë pjesëmarrje. Përfaqësuesit e këshillit bashkiak e konsiderojnë 33.3% të rëndësishëm dhe 66.7% shumë të rëndësishëm konsultimin.


<sup>11</sup> Jane intervistuar 4 Keshilltare, KryetarjadheSekretarja e KB



### ***Njohuria mbi bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore***


Shumica e të intervistuarve janë shprehur se e njohin mirë bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore. Vihet re se Këshilli Bashkiak ka një rregullore të mirëfilltë për realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit.

Rregullorja e funksionimit të KB të bashkisë ashtu edhe Rregullorja për ankesat kërkesat, nismat dhe peticionet saktëson secilin hap me qëllim sigurim të marrjes pjesë të publikut në vendimarrje. Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Bashkisë janë të qartë për afatet e njoftimeve, informimin dhe konsultimin me qytetarët, bazuar në ligj.




### **Vlerësimi mbi kuadrin ligjor**

Rreth 88.3% e anëtarëve të Këshillit Bashkiak e vlerësojnë kuadrin ligjor si të qartë dhe të plotë, ndërsa rreth 16.7.% e vlerësojnë si të paqartë por të plotë.



### Vlerësimi për rregulloret e Këshillit Bashkiak


Shumica e pjesëmarrësve në pyetsorë i vlerësojnë rregulloret e Këshillit Bashkiak si të qarta dhe të plota, ndërsa pjesa tjetër si të qarta dhe jo të plota. Gjithashtu ato janë pyetur nëse do kishte nevoja për rishikime apo plotësime cilat do të ishin rekomandimet, u shprehën se informacioni duhet të jetë më i thjeshtë në terma për qytetarët si dhe iniciativat qytetare duhet të jenë më transparente dhe duhet të ketë më shumë bashkëpunime.



### ***Bashkëpunimi mes Bashkisë Kukës dhe Këshillit Bashkiak***

Të intervistuarit janë përgjigjur në masën 100% sa i përket bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Kukës për procesin e njoftimit dhe informimit me publikun. {Shembulli më i mirë që ato japin janë zhvillimi i përbashkët i dëgjësave publike që janë realizuar në kuadër të hartimit të buxhetit 2022 si dhe PBA 2022-2024.}


Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit duke nisur me sektorin e IT-së për publikimin e njoftimeve dhe vendimeve, nëpërmjet njoftimeve mediatike, këndeve të njoftimit si dhe asistencë për transmetimin e mbledhjeve online.



### Publikimi i njoftimeve për mbledhje

Nga monitorimet e kryera vihet re se Këshilli Bashkiak Kukës {njofton për mbledhjet e këshillit 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Njoftimi për projekt-aktet e bëra publike në regjistrin elektronik mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: **a.** me postë elektronike; **b.** me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e hollit të Bashkisë; **c.** me një lajmërim në mediat audiovizive vendore; **d.** me botimin në gazetën bashkiake ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Të intervistuarit po ashtu kanë pohuar se ky rregull zbatohet plotësisht.






### ***Publikimi i akteve***


Neni 18 i ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: “Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim”.

Nga monitorimet e kryera në faqen web të bashkisë Kukës janë të publikuara të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak. Po ashtu, të gjithë të anketuarit e kanë pohuar këtë, ndërsa për publikimin e akteve në vende me akses të lirë publik kanë votuar në masën 50%, duke qenë se mund të publikohen vetëm akte të caktuara.




## Njoftimi dhe informimi i publikut

Këshilli Bashkiak Kukës ka të gjitha burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit për publikun. Njoftimi dhe informimi i publikut realizohet sipas formave të ndryshme të komunikimit duke përfshirë këtu mediat sociale apo takimet e drejtëpërdrejta me qytetarët.



## Regjistri Elektronik


Të intervistuarit janë pyetur gjithashtu mbi ekzistencën e regjistrit elektronik ku një pjesë janë në dijeni të këtij regjistri, i cili është i publikuar në faqen web të Bashkisë Kukës dhe një pjesë tjetër nuk janë në dijeni të këtij regjistri.



### Programet e transparencës në Këshillin Bashkiak

Anëtarët e këshillit Bashkiak janë pyetur nëse janë në dijeni për publikimin e programit të transparencës nga Bashkia Kukës dhe në masën 100% ato janë përgjigjur po.


Po ashtu, janë pyetur në lidhje me publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes dhe 100% e tyre kanë thënë se këshilli bashkiak publikon raporte të tilla. Programet e transparencës ndërtohen dhe publikohen vetëm nga Bashkia Kukës dhe jo nga Këshilli Bashkiak.



### Trajnimet në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin publik

Për pyetjen a kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin publik një pjesë e tyre janë përgjigjur se kanë marrë, ndërsa një pjesë tjetër janë përgjigjur që jo. Por, u shprehën se gjithmonë ka nevoja për trajnime të ndryshme, si psh: trajnime për projekt-vendime, në lidhje me konsultimin publik etj. Trajnimet janë të nevojshme

për një performim më të mirë në lidhje me informimet publike duke mësuar më shumë mbi praktikat dhe procedurat e sakta në kryerjen e detyrës.



## 8. Konkluzione

- Procesi i njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohet nga institucioni i Bashkisë Kukës dhe Këshillit Bashkiak si një proces shumë i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm me qëllim që të kontribuojë në rritje të transparencës dhe të rrisë pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes së qytetarëve.
- Strukturat kryesore në bashki të cilat ndihmojnë në informimin e publikut janë, marrëdhëniet me publikun dhe marrëdhënien me mediat si dhe punonjësi i caktuar për të drejtën e informimit si koordinatorë.
- Bashkia Kukës i ndërton komunikimet publike me qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me anë të medias massive.
- Faqet online të bashkisë Kukës përdoren më shumë për reklamim dhe pasqyrim të “arritjeve” dhe nuk fokusohet mjaftueshëm te dhënia e informacionit të vlefshëm dhe të vazhdueshëm për qytetarët.
- Regjistri elektronik, regjistri i peticioneve dhe nismave qytetare duhet të përditësohen periodikisht.

## 9. Rekomandime

- Realizimi i procesit të konsultimit publik ka nevojë për përmirësime, pasi duhet të nxiten qytetarët të marrin pjesë sa më shumë në diskutime publike dhe jo vetëm të ftuar apo punonjës të administratës. Gjetja e një mënyre atraktive për publikun dhe qytetarët është shumë e nevojshme.
- Bashkia duhet të përditësojë sa më shumë kanalet e saj të komunikimit online dhe offline si dhe të përdorë median lokale si pjesë e rendësishme në nivel komunitar në Kukës;
- Këshilli bashkiak i zhvillon mbledhjet e hapura dhe një pjesë e mirë e tyre zhvillohen dhe transmetohen online. Mbledhjet njoftohen në faqen zyrtare të FB të KB ku përfshihen edhe njoftimi për përmbledhjet e komisioneve. KB është mjaft pozitiv në qasjen dhe marrëdhënien me qytetarët.
- Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” çdo autoritet shtetëror duhet të ketë faqen e internetit ku duhet të publikojë një sërë informacionesh. Bashkia Kukës ka nevojë për përditësim të të dhënave dhe informacionit;
- Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve ka krijuar vështirësi në aksesin e informacionit apo shërbimit për shumë qytetarë. Me qëllim uljen e kostove për qytetarët, Bashkia mund të angazhojë burime të veta të trajnuara si në zonën urbane ashtu edhe në zonën rurale.

*Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:*

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra për Progres Rinor, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;